



Miratohet buxheti për arsimin dhe sportin

Buxheti i shtetit për vitin 2024 për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, do të jenë në vlerën prej 52 miliardë e 223 milion lekësh, me një rritje prej 10.7% në krahasim me vitin e kaluar. Buxheti për vitin 2024 në fushën e arsimit dhe sportit siguron një rritje të konsiderueshme të pagave, investime në arsim, në infrastrukturën arsimore dhe digjitale, zgjerimin e financimit për programet e arsimit të lartë, për ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor, mbështet nxënësit dhe studentët, si dhe financon programet sportive dhe promovon sportin si motor zhvillimi.



Mbështetje për shkollat artistike

Ministrja e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu, ka vijuar turin e dëgjësive me pedagogë në Universitetin e Arteve dhe drejtues të shkollave artistike, për të garantuar mbështetjen për zhvillimin e shkollave me drejtim artistik, përmes statusit të veçantë.



Laboratorë të rinj të inteligjencës artificiale

Nis faza e dytë e projektit të shtrirjes së laboratorëve të inteligjencës artificiale në 15 shkolla të tjera, për të rinjtë nga 13-19 vjeç, në kuadër të politikave të qeverisë shqiptare, Ministrisë së Arsimit dhe Sportit në bashkëpunim me Fondin Amerikano-Shqiptar për Zhvillim.

“Zgjidh zanatin”

Kryeministri Edi Rama dhe Ministrja e Arsimit dhe Sportit Ogerta Manastirliu, kanë zhvilluar një takim me drejtues të strukturave të shkollave profesionale, zyra arsimore, institucioneve dhe strukturave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe strukturave të Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, me fokus orientimin e nxënësve drejt arsimit profesional. Kryeministri Edi Rama dhe Ministrja Manastirliu e kanë cilësuar nxitjen e arsimit profesional, si një përgjigje ndaj zhvillimeve ekonomike, që aktualisht kërkon vendi dhe tregu i punës. Ndërkohë Ministrja Manastirliu ka vijuar në shkolla fushatën ‘Zgjidh Zanatin’.



Reforma në Arsimin Parashkollor



Ministrja e Arsimit dhe Sportit ka deklaruar se krye të listës së prioritetëve të punës së Ministrisë së Arsimit, do të jetë Reforma e Arsimit Parashkollor, e cila, do të konsistojë në: Rishikimin e plotë të paketës së akteve ligjore e nënligjore; standarde të reja të kujdesit, edukimit dhe arsimit të fëmijëve deri në 6 vjeç me fokus rishikimin e kurrikulës; forcimin e strukturës së inspeksionit dhe instrumentave të monitorimit; ngritjen dhe fuqizimin e mekanizmave të parandalimit dhe sinjalizimit të hershëm në arsimin parashkollor; një kornizë e re për vlerësimin të cilësisë në arsimin parashkollor me standartet e reja për punësimin dhe edukimin në vazhdim të edukatorëve në këtë sistem.

SAMITI I III-TË I DIASPORËS

Samiti i Tretë të Diasporës u mbajt në Tiranë, si vazhdim i një tradite të rëndësishme në vitet e fundit, ku mësues e akademikë të diasporës shqiptare u mbledhën për të diskutuar, shkëmbyer ide, dhënë sygjerime dhe kontribuar në zhvillimin e vendit tonë. “Diaspora akademike si urë lidhëse për ndërkombëtarizimin dhe kërkimin shkencor në universitetet shqiptare” dhe “Politikat shtetërore në mbështetje të mësimdhënies së gjuhës shqipe në diasporë” ishin panelet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, ku u ndanë mendime nga përfaqësues të shquar të diasporës akademike.



INVESTIMET NË SHKOLLA

Edhe dy shkolla të reja rindërtohen me standarde evropian, hqolla 9-vjeçare “Servet Agolli” dhe gjimnazi “14 Engjëjt”, janë dy shkollat e sapo rikonstruktuar në Buçimas të Pogradecit, me një financim të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, në bashkëpunim me bashkinë Pogradec, të cilat kanë hapur dyert për të garantuar një mjedis mësimor bashkëkohor për nxënësit dhe mësuesit.